



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:031269

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05448669

Ac.nr.934/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, nga gjyqtari individual Adnan Konushevci, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “S”, me seli në Prishtinë, Rruga “Perandori Justinian”, Nr. 69, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.J., avokate nga Prishtina, ndaj debitorit K.B nga Komuna Sh.. Rruga “S.S.”, Nr.199, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit PPP.nr.73/21 datë 28.12.2021, të Gjykatës Themelore në Ferizaj, me datë 13.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Scardian”, me seli në Prishtinë, Rruga “Perandori Justinian”, Nr. 69, ndërsa aktvendimi PPP.nr.73/21 datë 28.12.2021, i Gjykatës Themelore në Ferizaj, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.73/21 të datës 28.12.2021, ka vendosur, në pikën -I- të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.20/2021 i datës 26.01.2021, i lëshuar nga zyra përmbartimore Metaj Law nga Prishtina, shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.20/2021, i datës 26.01.2021 dhe refuzohet në tërësi si i pabazuar propozimi për përmbartim i kreditorit, i ushtruar kundër debitorit. Në pikën -II- e ka urdhëruar kreditorin që kërkesën e tij ndaj debitorit ta realizoj në procedurën kontestimore, pranë gjykatës kompetente.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovoj ankesën e kreditorit si të bazuar, të ndryshoj aktvendimin e ankimuar duke vendosur që të lejoj propozimin për përmbarim.

Debitorit nuk ka ushtuar përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimor (LPK), gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr. 326810 të datës 27.09.2019, në shumën e përgjithshme për pagesë prej 2,332.00 euro. Përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin me urdhrin P.nr.20/2021 i datës 26.01.2021, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim me datën 09.02.2021, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 12.02.2021. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim si dhe pas mbajtës së seancës dëgjimore vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin për përmbarim P.nr.20/2021 të datës 26.01.2021, duke vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje kontestimore, andaj rasti lëndor nuk është objekt i kësaj çështje përmbarimore pasi që nuk është në harmoni me ligjin e LPP-së, për arsye se fatura e bashkangjitur nuk i plotëson kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që e

njëjta nuk është pranuar dhe nuk është e nënshkruar nga debitori. Sipas dispozitës së nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, përcaktohet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, e po ashtu me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht në nenin 20, paragrafi 1.1.17, përcaktohet se: “në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore”, andaj në rastin konkret gjykata me të drejt ka vlerësuar se fatura në bazë të cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm sipas ligjit pasi që nuk është e pranuar dhe e nënshkruar nga debitori. Nënshkrimi nga palët në marrëdhënie detyrimi nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve të kryera nga kreditori dhe pohimin se ekziston borxhi ndaj kreditorit sipas faturave.

Pretendimi ankimor i të autorizuarit të kreditorit se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar e ka konstatuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se borxhi që kreditori e kërkon nga debitori duhet të jetë objekt i procedurës kontestimore, pasi që propozimi për përmbartim i kreditorit përmban të gjitha kushtet e kërkuara me nenin 38 të LPP-së. Gjykata e Apelit një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar për arsye se lidhur me borxhin lëndor dy vite, më për para së të iniciohet kjo procedurë përmbartimor nga debitori është iniciuar proceduara kontestimore pikërisht lidhur me kontratën e sigurimit shëndetësor prej nga ka rrjedhur edhe fatura mbi të cilin është lejuar përmbartimi. Për me tepër fatura lëndore nuk është e nënshkruar nga debitori, siç është përcaktuar në neni 21 të LPP-së, organi përmbartues e cakton përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm. Në rastin konkret dokumenti i besueshëm në bazë të cilit është lejuar përmbartimi sipas dispozitave të lartcekura, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, sepse përveç arsyeve të lartcekura, fatura lëndore që është paraqitur shuma e borxhit, nuk korrespondon me shumën e borxhit të kërkuar nga kreditori në propozim për përmbartim, poashtu kjo gjykatë e ka vlerësuar edhe deklaratën e kreditorit për arritshmërinë e kërkesë, që është përpiluar në kuptim të nenit 30 të LPP-së, mirëpo edhe kjo deklaratë e kreditorit ishte pa ndikim për vendosje ndryshe në këtë rast sepse deklarata e arritshmërisë së borxhit, duhet të rrjedh dhe të jetë në harmoni me propozimin për përmbartimin dhe me dokumentet mbi të cilat kërkohet që të lejohet përmbartimi, që në këtë rast siç u arsyetua më lart dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbartimi nuk ka qenë në harmoni me propozimin për përmbartim për sa i për ketë shumës së mjeteve monetare të kërkuara nga kreditori e rrjedhimisht edhe deklarata për arritshmëri e kërkesë rezulton të jetë kundërthënëse, andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të

aktvendimit të ankimuar kur e ka anuluar urdhrin për përmbarim, për shkak se dokumenti i besueshëm nuk i plotëson kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e të autorizuarit të kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.934/22 datë 13.03.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci